

Jusuf (Isuf) Vrioni, (1916-2001)



SEKSIONI

Intelektualë, shkencëtarë

PERIUDHA

1947 - 1991

Jusuf Vrioni (16 mars 1916 – 1 qershor 2001) lindi në Korfuz . Ishte djali i Iliaz Vrionit , ish-kryeministër dhe diplomat shqiptar. Studioi në Francë dhe Itali, ku mori titullin “Doktor në Drejtësi”. U kthye në Shqipëri më 1939, por në vitin 1947 u arrestua nga regjimi komunist si “agjent francez” dhe u dënua me 15 vjet burg. Pas lirimit punoi si përkthyes, duke sjellë në frëngjisht veprat e Ismail Kadare dhe disa libra të Enver Hoxha . Pas rënies së komunizmit u emërua ambasador pranë UNESCO në Paris. Në vitin 2006 Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë krijoi çmimin e përkthimit “Jusuf Vrioni”. Në vitin 1998 u dekorua nga Franca me titullin “Chevalier de la Légion d’Honneur”. Vdiq në Paris më 2001.

KULTURA SHQIPTARE NË BOTË


UNESCO

Dokumentacioni për Jusuf (Isuf) Vrionin në dosjet e Sigurimit të Shtetit

Dokumentacioni për Jusuf (Isuf) Vrionin në dosjet e Sigurimit të Shtetit gjendet në dy dosje: dosjen hetimore-gjyqësore nr. 1355-A dhe dosjen e përpunimit nr. 1452. Dosja hetimore-gjyqësore nr. 1355-A është një përmbledhje hetimore dhe procesi gjyqësor i 17 të akuzuarve si agjentë francezë: Agostin Bonati, Skënder Konica, Skënder Shkupi, lindur në Shkup, Guliem Rasku, Rakip Strazimiri, Isuf Vrioni (Jusuf Vrioni), Agop Hamexhani, Simon Rasku, Fridë Sadedini, Adem Pilku, Padër Paskal Gjudei, Lush Pogu, Gjysh Shkreli, Elena Beçi, Lucia Kola, Gjon Cefa, Kosta Meksi. Të 17 personat akuzohen si agjentë francezë, që kanë dhënë informata Misionit Francez e më pas Legatës Franceze të vendosur në Tiranë. Tri nga të akuzuarit ishin shtetas të huaj (bullgar, armen dhe francez), gjysma prej tyre me arsim të lartë (në akademi diplomatike, tregtare, për drejtësi, mjekësi, ushtarake, klerik, funksionar në legatën franceze), pjesa tjetër tregtar, teknikë, sipërmarrës deri tek zanatçinj të thjeshtë kishin në mënyra të ndryshme lidhje me shtetin francez dhe shtetasit e funksionarët francezë në Shqipëri. Të ardhur përgjithësisht nga shtresa e lartë dhe e mesme e shoqërisë shqiptare të paraluftës, ishin persona që kishin lëvizur, kishin jetuar e punuar në disa vende të Europës. I akuzuari kryesor Agostin Bonati, punonjës i Legatës Franceze u dënua me vdekje me pushkatim, të terët me dënime nga 20 deri në 5 vjet. Rakip Strazimiri iu shua akuza për shkak se kishte vdekur gjatë hetuesisë. Arrestimet kanë nisur në maj të vitit 1947-maj 1949. Në procesin gjyqësor, gjashtë prej tyre (Agostin Bonati, Skender Konica, Skënder Shkupi, Patër Gjadri, Luçia Kola, Kosta Meksi) nuk i kanë pranuar deklaratat e bëra në hetuesi, duke thënë se janë marrë nën torturë. Avokatët e çështjes, Gaqo Stefa, Vangjel Xhomaka, ishin avokatë të Ministrisë së Brendshme Procesi me trupën gjyqësore Mustafa Iliazi, (kap. I) – kryetar dhe Shaban Rexha (kap. I), Veli Lilaj (n/toger) – anëtarë, Mstan Cake (rreshter) – sekretar dhe Hilmi Telegrafi- prokuror nisi në 7 janar 1950 dhe vendimi nr. 301 i gjykatës ushtarake të Tiranës u mor në 8.7.1950. Vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake nr.161, datë 29.7.950 vendosi ligjërimin e vendimit nr. 301, datë 8.7.1950 të Gjykatës Ushtarake Dosja përmban aktakuzë, procesverbale, fotografi, letra, vendimin e gjykatës ushtarake dhe vendimin e apelimit, ballafaqime Njëri prej të akuzuarve në këtë proces ishte Isuf (Jusuf) Vrioni i cili u akuzua për faje penale kundra shtetit, anëtar i organizatës tradhëtare social-demokrate dhe si agjent i spiunazhit francez në Tiranë. U arrestua më 13.7.1947 dhe doli në gjyq në 7 janar të vitit 1950. Me vendimin nr. 301, datë 8.7.1950 të Gjykatës Ushtarake të Tiranës dhe vendimin nr.161, datë 29.7.950 Gjykatës së Lartë Ushtarake u dënua me 15 vjet privim lirie pune të detyruar dhe heqjen e së drejtës elektorale për 5 vjet. Dosja e përpunimit nr.1452 është hapur në vitin 1964. Ajo përmban disa dokumente nga dënimi penal i Isuf Vrionit, raporte informimi nga të cilat merret iniciativa për ngritjen në përpunim 2A, plane masash, ekstrakte, detyra, deklarata, 3 foto dhe letra. Dosja mbyllet me vendimin e datës 27.7.1991 të Drejtorisë së Punëve të Brendshme.

Dosja nr. 1355-A

MEDIA FAQE #1



Dosja nr. 1355-A

INFORMACION

Dosja nr. 1355-A


FONDI	Nr. 1, hetimor-gjyqësor
STRUKTURA	Gjykata Ushtarake e Tiranës
DOSJA	1355-A
VITET EKSTREME	1947-1956
SASIA E FLETËVE	712
DATA E KRIJIMIT	-
LLOJI I DOKUMENTIT	Dosje hetimore-gjyqësore

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Kapaku i dosjes së përpunimit

MEDIA FAQE #1



Kapaku i dosjes së përpunimit

INFORMACION

Kapaku i dosjes së përpunimit


FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
STRUKTURA	Drejtoria e Punëve të Brendshme, Dega Tiranë
VITET EKSTREME	1964-1991
SASIA E FLETËVE	171
DATA E KRIJIMIT	29.02.1964
GJUHA	Shqip
TIPOLOGJIA E DOSJES	Dosje përpunimi

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Foto

MEDIA FAQE #1



Foto

INFORMACION

Foto

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	1452
VITET EKSTREME	1964-1991
SASIA E FLETËVE	171

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Aktakuzë

MEDIA FAQE #1

MINISTRIA E PËRRENDSHKË
DREKTORIA SIGURIMIT SËKRETIT
=Dega e VII-të=

Tirane, më 1947.

AKT - AKUZË

Sig do të shifet dhe nga përmbajtja e akteve hetimore që u bashkë-ngjitet; rezultatit të :
1-Pandehuri Isuf Vrioni: Mbi i të ndjerit Iljaz dhe i së gjallesë M vjeç 33, lindur në Korçuz dhe banues në Tiranë, ish nëpunës në Sekretariatit të S.G.A.S.H.-it, me arsim të lartë Universitet për Drejtësi e i re-
sti, i pa martuar, adresë veçorësh qytetare, ekonomikisht i pesëm, i pa de-
nuar ndonji here dhe i paraburgosur me datë 13 Shtator 1947.-
Akuzohet se :
1-Mbas qllirimit të vendit, ka mbajtur qendrim armiqësor, duke u lidhur
gjithmonë me elementin reaksionar, që ka tepër me antarët e misionave ush-
tarake të huaj, si me V - G, M - A, S - T, L
dhe M/Togerin M - S te cilët takoheshin përditë në tenis-mallban, gjodja për
qellime lojë, dhe në pushimet, tok me shokët e tyre A - B, S -
V - G, S - V, V - G, V - A, T - S
e tjer, bisedonin çështje politike, ekonomike dhe shqetësime, u jepnin
informata ktyre mbi gjendjen e vendit dhe marrëditjet ndërmjet tyre se si
do të vepronin në punën e përditshme kundër interesave të vendit, duke para-
qitur një ndërmjet të situatës nga një shprehje e shpejtë i Anglo-Amerikanëve.-
Me rastin e shprehjes së kësaj nga dhënë gjilje, që në të u lëshoi
me se 20 familje bujqesh, u tregua dhe shifit të klasës hapëzari kundër Pushtet-
etit, reformës agrare dhe reformave të ndryshme.-
2-Mbas daljes së ligjes elektorale mbi zgjedhjet e 2 Dhjetorit
1945, zori kontakt me F - V, me anën e S - A, q'fajti de-
shirën që ky i fundit të përkonte një grup opozite për në votimet, me sistem
kryej përdorim dhe bledhi zgjedhjet ka formuluar një taktikë në gjyken
frangdike dhe ja u dërgojë gazetarëve Anglo-Amerikan, kopjen e të cilit e
përktheu në gjuhën Anglisht F - V - A -
3-I pa ngopur në punën e tij armiqësore, njerëzjet të krye-agjentit
A - S, vithet me shërbim të spiunazhit francez dhe jep qdo informata
me gojë dhe shkrim në qendrën dhe për këtë shërbim paguhet me një rrogë
gjatë kohës, me muaj dhe sa here që i depje ndonji informata
të rëndësishme, shpërblime plus rrogës që marrte.-
Ka dhënë informata mbi Sekretariatit të Gruas ku i pandehuri shërben-
te; ka dhënë gjithashtu informata dhe mbi Sekretariatit të Rinisë, dhe ka vonë
ngatëzohet që të informojë dhe për çështje politike, ekonomike, shqetësime dhe
ushtarake.-
4-Ka vonë për aftësi dhe besim në punë, ngarkohet që të rekrutojë dhe
informatorë të rij në shërbim të spiunazhit francez, duke u bazuar në ele-
mentin e pa kësaj dhe armik të Pushtetit në administratën shtetnore, ku bi-
le ka rekrutuar dhe S - V që punonte në Kryeministri.-
Të gjitha të provohet
Me deponimet e krye-agjentit A - S dhe ato të ndihmesit të
tij S - K, dhe me deponimet e të pandehurit S - S, të bane
në proces verbalit e tyre, me ballafaqimet e S - S, S - A, dhe fa-
A - S, me një ekstrakt të D - D që u bashkëngjitet, dhe me
shtatë deklarata të lëshuara prej tij, të cilat tash i mohon; si dhe me shtatë
deklarata të lëshuara nga S - V, që dhe këto u bashkëngjiten.-
Përfundim i punës:
Me gjithë se në proces nuk ka pranuar, neve dyshojmë se gjatë okupa-
cionit të kësaj ba pjesë në organizatat trahitare të ballit dhe legalitetit
qdo

Aktakuzë

MEDIA FAQE #2

-2-

dhe të kësaj mbajti lidhje të ngushta me eksponentët e tyre Gago Waga dhe
Kadri Cakrani, gjë që kjo i provohet dhe nga S - K, -
Dyshojmë gjithashtu që të kësaj ba pjesë në një grup t'organizatës So-
cial Demokratë me në krye F - V, ku dhe ky grup organizatë kishte
për qëllim t'ushtroje punë armiqësore në dam të Pushtetit Popullor dhe në
interese të të huajve.-
Rrethkrahërimi shqetësor:
Nga vete përmbajtja e proces verbalit të tij, shifet kështu se i pan-
dehuri paraqet një rrethkrahërimi shqetësor të theksuar, dhe fomojë bindje
se asht i tillë kur shohim dhe qendrimin e tij rezistent dhe armiqësor, duke
mbrojtur me vendosmëri punën e tij armiqësore n'interese të armiqve të jash-
tës.-
Qendrimi në hetuesi :
Përpara hetuesisë, ka mbajti një qendrim nga ma armiqësorët, duke qendru-
shumë i vendosur në krugën e trahitise dhe duke mos pranuar asnjë nga aku-
zat që atribuoheshin, por ma e keqja asht se n'asnjë mënyrë nuk përgjigjesh
rreth pyetjeve që i bëheshin, duke pretenduar se këta janë pyetje pa vend dhe
te shprehur, se një fjalë kerkonte që hetuesit të ndiqni një formë proce-
duriale t'aktive që deshinonë ky, dhe këtu e kësaj gjithmonë në një kohë
kur vekesh në pozitë të vështira dhe kur nuk kish ndonji bazë mbrojtëse.-
Për të bërë fjalë mbi qendrimin e tij para hetuesisë, don kohë, por
mjafton të përmendim se kur asht ballafaquar prej S - K, me një in-
ton ma brutal dhe armiqësor, e ofendon kësaj (S - K), duke i thënë prej ma-
se shume here, i poshtër, kjo nënkupton se e bërë në qellim që t'a fri-
qonte S - K dhe të mos tregonte aktivitetin armiqësor. Mjafton të përmend-
dih gjithashtu dhe deklaratën e shprehur prej tij që u bashkëngjitet, me
te cilën verteton se nuk i asht përgjigjur pyetjeve që i bëheshin, duke thënë
se kësaj pyetjeje në mënyrë lakonike nuk mund t'i përgjigje.-
Përsa sipër, tue qenë se i pandehuri ka kryer fajë penale kundër Popu-
llit të Shtetit, të parashikuar dhe ndëshkuar prej nenëve 2,3 e t.j, të li-
gjes Nr.372; datë 12 /III/ 1946, ja referohen aktet për kompetencë e referia
gjykatës kompetente për gjykimin e tij.-
Ministri P. Merendash
Gjeneral i Shtetit
(Mendash)

INFORMACION

Aktakuzë


FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
VITET EKSTREME	1964-1991
DATA E KRIJIMIT	1949
SASIA E FLETËVE	171
KRIJUAR NGA	Mehmet Shehu, Ministër i Punëve të Brendshme
LLOJI I DOKUMENTIT	Aktakuzë

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.


Mbrojtja ne gjyq

MEDIA FAQE #1



Mbrojtja ne gjyq

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Mbrojtja ne gjyq


FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme
DOSJA	1355-A
VITET EKSTREME	1964-1991
SASIA E FLETËVE	171
AVOKAT	Gaqo Stefo

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.


Raport propozimi

MEDIA FAQE #1



Raport propozimi

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Raport propozimi


FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
VITET EKSTREME	1964-1991
SASIA E FLETËVE	171
DATA E KRIJIMIT	29.02.1964
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Raport-propozim
PUNETORI OPERATIV	Shyqyri Karemani
APROVUAR NGA	Koço Pano, zëvendës drejtor e Puneve të Brendshme

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Raport

MEDIA FAQE #1



Raport

INFORMACION

Raport

FONDI	Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë
DOSJA	Nr. 1452
VITET EKSTREME	1964-1991
SASIA E FLETËVE	171
DATA E KRIJIMIT	23.10.1967
PUNETORI OPERATIV	Riza Braho

TRANSKRIPT

